



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

Prokurori kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit

Vendosi: Gjykatësi i Procedurës Paraprake

Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 27 janar 2022

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Urdhër për Ndryshimin e Afateve

Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Mbrojtjes së Hashim Thaçit

Gregori Kihou

Mbrojtjes së viktimave

Sajmon Loz

Mbrojtjes së Kadri Veselit

Ben Emerson

Mbrojtjes së Rexhep Selimit

Dejvid Jang

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit

Venkatesvari Alagenda

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në përputhje me nenin 39(1) dhe (13) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar dhe rregullat 9(5)(a) dhe 76 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), lëshon këtë urdhër.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 27 janar 2022, Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) dorëzoi “Kërkesë e Prokurorisë për Zgjatjen e Afatit” (“Kërkesa”), me anë të së cilës kërkonte që Gjykatësi i Procedurës Paraprake të miratonte zgjatjen e afatit për nxjerrjen e një numri të kufizuar materialesh të rregullës 102(1)(b) përtej afatit të caktuar më 31 janar 2022.²

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

2. Në përputhje me rregullën 9(5)(a) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *proprio motu*, mund të shkurtojë afatet e përcaktuara prej Rregullores ose prej Panelit.

3. Në përputhje me rregullën 76 të Rregullores, përgjigjja ndaj një mocioni dorëzohet brenda dhjetë (10) ditësh prej dorëzimit të mocionit dhe kundërpërgjigjja ndaj përgjigjes dorëzohet brenda pesë (5) ditësh prej dorëzimit të përgjigjes.

III. DISKUTIM

4. Në përputhje me rregullën 76 të Rregullores, Mbrojtja e të akuzuarave të ndryshëm ka të drejtë t’i përgjigjet Kërkesës brenda dhjetë ditësh, dhe ZPS-ja ka të drejtë të kundërpërgjigjet brenda pesë ditësh nga dorëzimi i përgjigjes/përgjigjeve.

¹ KSC-BC-2020-06, F00001, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 23 prill 2020, publik.

² KSC-BC-2020-06, F00657, Prokurori i Specializuar, *Kërkesë e Prokurorisë për Zgjatjen e Afatit*, 27 janar 2022, konfidenciale. Versioni i redaktuar publik u dorëzua në të njëjtën ditë, F00657/RED.

5. Duke pasur parasysh afatin e 31 janarit 2022 për nxjerrjen e materialit të mbetur të rregullës 102(1)(b) dhe kohën që nevojitet për të marrë vendim lidhur me Kërkesën, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e gjykon të nevojshme të shkurtojë afatet përkatëse për përgjigjet dhe kundërpërgjigjen. Rrjedhimisht, në qoftë se Mbrojtja e të akuzuarve të ndryshëm vendos të përgjigjet, urdhërohet ta bëjnë një gjë të tillë deri në orën 16:00 të ditës së premte, 28 janar 2022. Në qoftë se ZPS-ja vendos të kundërpërgjigjet, urdhërohet ta bëjë një gjë të tillë deri në mesditën e ditës së hënë, 31 janar 2022.

IV. VENDIM

6. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

- a. **URDHËRON** Mbrojtjen e të akuzuarve të ndryshëm që përgjigjen ndaj Kërkesës, në qoftë se dëshirojnë, ta parashtrojnë deri në orën 16:00 të ditës së **premtë, 28 janar 2022**; dhe
- b. **URDHËRON** ZPS-në që kundërpërgjigjen ndaj përgjigjes/përgjigjeve, në qoftë se dëshiron, ta parashtrojë deri në mesditën e ditës së **hënë, 31 janar 2022**.

 /nënshkrimi/

Gjykatës Nikola Giju

Gjykatës i Procedurës Paraprake

E enjte, 27 janar 2022

Hagë, Holandë.